REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË**
**REKTORATI**

Nr. 758/12 prot. Vlorë, më 30. 04. 2021

**VENDIM**

**Nr. 13, datë 30. 04. 2021**

**PËR**
**NGRITJEN E BORDIT KËSHILLUES TË BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM NË NJËSITË KRYESORE NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË**

Mbështetur në nenin 40 të Ligjit Nr. 80/2015 "*Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*", nenin 26 të Statutit të Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë, si dhe referuar shkresës nr. 713 prot, datë 26. 04. 2021 të Zv/ Rektorit për kërkimin shkencor dhe zhvillimin institucional, Rektorati në mbledhjen e datës 30. 04. 2021,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë në parim propozimin e Zv/ Rektorit për Kërkimin Shkencor dhe Zhvillimin Institucional, për nisjen e procedurës për ngritjen e Bordit Këshillues të Bashkëpunëtorëve të Jashtëm pranë çdo Njësie Kryesore në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.
2. Vendimi i përcillet Senatit Akademik për miratim përfundimtar.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**R E K T O R I**

**Prof. Dr. Roland ZISI**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË

ZV. REKTOR PËR KËRKIMIN SHKENCOR DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL

Nr. 313 Prot

Vlorë, më 26/ 04 / 2021

**Lënda:** Propozim per ngritjen e Bordit Këshillues të Bashkëpunëtorëve të Jashtëm pranë çdo Njësie Kryesore në Universitetin "Ismal Qemali Vlorë".

**REKTORIT**
**PROF. DR. ROLAND ZISI**

Në zbatimin e Standardeve Shtetërore për Sigurimin e Cilësisë të Kodit të Cilësisë i miratur me VKM Nr. 531, datë 11.09.2018, më specifikisht:

**Stadardi II.4, Kriteri 9**: *Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.* (Standardet për Sigurimin e Cilësisë për Programet "Bachelor", "Master Profesional" dhe "Master Shkencor")

**Standardi VI.1, Kriteri 2**: *Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë d*

*he zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.* (Standardet për Sigurimin e Cilësisë për Programet " Bachelor", "Master Profesional" dhe "Master Shkencor")

**Stadnadrdi VI.4, Kriteri 5** *Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.* (Standardet për Sigurimin e Cilësisë për Programet " Bachelor", "Master Profesional" dhe "Master Shkencor")

**Standardi II.6** *Institucioni i arsimit të lartë inkurajon përfshirjen e studentëve dhe partnerëve në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe realizimin me sukses të tyre* (Standardet për Sigurimin e Cilësisë për Programet "Master Profesional" dhe "Master Shkencor")

*Rezulatet e pritshme të këtyre aktiviteteve janë hapja e programeve të studimit me kërkesat e tregut të punës, përmirësimi i programve të studimit me qëllim aftësimin e studentëve me koompetenca praktike etj.*

**ZV. REKTOR PËR KËRKIMIN SHKENCOR
DHE ZHVILLIMIN INSTITUCIONAL**

**PhD. Enkelejd Mëhilli**